



Planuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	20.05	2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPM/SHK	2953/2022		114	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.337/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.337/2022 të datës 06.04.2022 të parashtruar nga ankuesit

dhe të cilët me autorizim i përfaqëson me adresë kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.337/2022 e datës 06.04.2022 e parashtruar nga ankuesit:
dhe

A r s y e t i m

Ankuesit: sipas kontratës me numër reference 07/1-01A/0363 të datës 16.05.20005 në pozitën “Radiokomunikues dhe baza e të dhënave” në Stacionin Policor-Sektorin i Operatives në Prizren,
sipas kontratës me numër reference 7/1-01A/0361 të datës 16.05.20005 në pozitën “Shef i administratës dhe personelit” në Stacionin Policor-Sektorin e Resurseve në Prizren,
sipas kontratës me numër 07/1-01A/0357 të datës 16.08.20005 në pozitën “Zyrtar në Mto dhe Logjistikë” në Stacionin Policor-Zyra për Shërbime Mbështetëse në Prizren,
sipas kontratës me numër reference 07/1-01A/0395 të datës 26.01.2004 në pozitën “Radiokomunikues dhe baza e të dhënave” në Stacionin Policor-Sektorin e Operativës në Prizren, ,
sipas kontratës me numër reference 07/1-01A/0354 të datës 16.05.2005 në pozitën

“Nëpunës” në Stacionin Policor ne Prizren, sipas kontratës me numër reference 07/1-01A/0362 të datës 16.05.2005 në pozitën “Zyrtar në bazën e të dhënave” në Stacionin Policor-Sektorin e Operativës -Zyra e SIPK-ut dhe sipas kontratës me numër reference 07/1-01A/1504 të datës 26.09.2005 në pozitën “Udhëheqës i Njesisë për shërbime Mbështetëse” në Stacionin Policor-Sektorin Rajonal për Resurse, Njësia për Shërbime Mbështetëse në Gjakovë të punësuar në Policinë e Kosovës, me datën 04.03.2022, përmes përfaqësuesit ligjor kanë parashtruar kërkesë/ankesë për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Policinë e Kosovës, lidhur me harmonizimin e koeficienteve dhe kompensimin e pagesës adekuate që nga data 02.11.2015.

Me datën 29.03.2022, Drejtori i Divizionit për Personel dhe Administratë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Kosovës, ka kthyer përgjigjen sipas të cilës ankuesit janë njoftuar se koeficientet janë përcaktuar nga DMZP (ish MAP) dhe të njëjtit vazhdojnë të marrin pagën konfor koeficienteve të tyre, gjithashtu ky institucion i ka njoftuar ankuesit se përshkrimi i detyrave të punës është hartuar në pajtim me katalogun e përshkrimit të detyrave dhe rregulloren për klasifikim të vendeve të punës (në të kaluarën) dhe me pas këto pozita janë dorëzuar në DMZP (ish MAP) për aprovim të klasifikimit të vendeve të punës por që deri me tani Policia e Kosovës nuk ka pasur aprovim të klasifikimit të vendeve të punës për shërbyes civil.

Të pakënaqur me përgjigjen e Policisë së Kosovës konfor kërkesës së datës 04.03.2022, ankuesit përmes përfaqësuesit të tyre, me datën 06.04.2022, kanë parashtruar ankesën më numër protokoll 1908/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me harmonizimin e koeficienteve të ankuesve me pozitat e tyre si dhe kompensimin e pagesës adekuate nga datat e precizuara në kërkesat personale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, me datën 14.04.2022, ankesën e ankuesve e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës. Policia e Kosovës me datën 11.05.2022 ka përcjell shkresat lidhur me dokumentacionin e kërkuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot: 1908/2022 të datës 06.04.2022 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërtetimin mbi pranimin e dërgesës të datës 05.03.2022 nga Posta e Kosovës; Prova shtesë nga përfaqësuesi ligjor i ankuesve të datës 17.05.2022; Autorizimin e datës 30.03.2022 lidhur me nënshkrimet e ankuesve për përfaqësuesin ligjor të tyre; Vendimin me numër 1127 të datës 28.10.2010 nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 14.04.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 11.05.2022 nga Policia e Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar me numër të referencës 07/1-01A/0363 të datës 16.05.2005 për ankuesin . Kontratën e punës për kohë të pacaktuar me numër të referencës 07/1-01A/0361 të datës 16.05.2005 për ankuesin

Kontratën e punës për kohë të pacaktuar me numër të referencës 07/1-01A/0357 të datës 16.05.2005 për ankuesin Kontratën e punës për kohë të pacaktuar me numër të referencës 07/1-01A/0395 të datës 26.01.2004 për ankuesin Kontratën e punës për

kohë të pacaktuar me numër të referencës 07/1-01A/0354 të datës 16.05.2005 për ankuesin

Kontratën e punës për kohë të pacaktuar me numër të referencës 07/1-01A/0362 të datës 16.05.2005 për ankuesin

Kontratën e punës për kohë të pacaktuar me numër të referencës 07/1-01A/1504 të datës 26.09.2005 për ankuesin

Kërkesat e ankuesve të datës 04.03.2022 përmes përfaqësuesit të tyre të parashtruara në Policinë e Kosovës; Përgjigjen e datës 29.03.2022 nga Policia e Kosovës në kërkesat e ankuesve; Emailin zyrtar të datës 18.05.2022 lidhur me provat shtese për Listat e pagave për ankuesit për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor për vitet 2020, 2021 si dhe muajt janar, shkurt dhe mars të vitit 2022 si dhe e-mailin zyrtar të datës 17.05.2022 lidhur me kërkesën për prova shtesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesve dhe

, është e pabazuar, SEPSE:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesve ju referua dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 ku është përcaktuar se: "1. E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil", ndërsa neni 9 paragrafi 1 i po këtij Ligji përcakton se: "Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kantatës së punës", dhe rrjedhimisht konstatoj se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësi civil gëzon të drejtën e realizimit të pagës të përcaktuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës. Në kuptim të kësaj baze ligjore dhe duke marrë parasysh shkresat e lëndës lidhur me listën e pagave për ankuesit, Kolegji ka konstatuar se ankuesit të sistemuar në bazë të kontratave të punës në pozitat të cilat i mbajnë, realizojnë pagën në vlerën e përcaktuar sipas kushteve të kontratave të tyre dhe meqenëse Kolegji në provat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë kontratë apo akt tjetër administrativ të organit të punësimit lidhur me harmonizim të koeficientit për pozitat e ankuesve, vlerëson se pretendimi ankimor i tyre për harmonizimin e koeficienteve, si dhe kompensimi i diferencës së pagës në mënyrë retroaktive është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, po ashtu gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit gjegjësisht Policia e Kosovës, duke ju referuar dispozitave të nenit 7 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ka bërë kërkesë pranë ministrisë përgjegjëse për administratë publike, lidhur me ngritjen e koeficientëve të pagës për disa pozita të punës duke përfshi edhe pozitat e ankuesve, por që një kërkesë e tillë nuk është shqyrtuar nga kjo e fundit.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.337/2022, datë 20.05.2022.

Ardita Perçuku-Shyti



Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI



Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Përfaqësuesit të ankuesve,
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së

